

Më
Data

21-03-2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykuës Mustafë Tahiri, me sekretarën juridike Drita Ejupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, P/II.nr.2033-4/17, e dt.17.11.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt. 12.12.2017, mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Ferizaj, P/II.nr.2033-4/17, e dt.17.11.2017, dhe kjo gjykatë lëshon:

URDHËR NDËSHKIMOR**I pandehuri:**

[REDAKTUAR] i biri i [REDAKTUAR] i lindur më [REDAKTUAR], në fshatin [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR**S e p s e:**

Me dt.08.09.2017, rreth orës 16:00h, në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomik-pyJOR Nerodime-Jezerc, në vendin e quajtur "Plenija", me qëllim vjedhje ka prerë 1 dru të llojit ahut me diametër 49-60cm, boniteti III, gjithsejtë në kubaturë prej 3.00m kub, vlera e dëmit të shkaktuar është 405,00Euro, të cilat drunjë i ka bartur me traktor.

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe nenit 495 par. 1 të KPPRK-së, e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim në gjobë në shumë prej 150 (njëqindpesëdhjetë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma të tjera sipas nenit 46 të KPK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që te dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural zyra në Ferizaj, ti kompensoj dëmin në vlerën prej 405.00€ në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 30 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, P/II.nr.2033-4/17, e dt.17.11.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar edhe dhënien-lëshimin e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe shkresat tjera të lëndës, lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtet ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata duke shqyrtuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vlerëson se ka prova të besueshme, lidhur me bazueshmërinë e Aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve dhe erdhi në përfundim se i pandehuri vërtet e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 495 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPRK-së dhe konform nenit 495 par. 1 të këtij kodi mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.2908/17 e dt.12.12.2017

Sekretarja juridike
Drita Ejupi



Gjyqtari i vetëm gjykues
Mustafë Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhri ndëshkimorë merr formën e prerë.

E. X. P.
12.12.17
